



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

Nr.581/5 prot.

Tiranë, më 26.05.2026

V E N D I M

PARALAJMËRIMI

Nr. 58, datë 26.05.2026

**MBI PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË VLERËSIMIT TË LIGJSHMËRISË, NË
LIDHJE ME VEPRIMET ADMINISTRATIVE TË KRYERA GJATË PROCESIT
TË ECURISË DISIPLINORE, NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT
DHE PARALAJMËRIMIN E INSTITUCIONIT PËR TË RREGULLUAR
PALIGJSHMËRINË E KONSTATUAR**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi Procedurat e Mbikëqyrjes/Inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit të veprimeve administrative të kryera gjatë procedimit disiplinor, në ngarkim të nëpunësit Fatbardh Zenelaj, me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm”, pranë institucionit të Avokatit të Popullit,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me shkresat nr. 581 prot., datë 06.05.2026, dhe nr. 581/1 prot., datë 11.05.2026 ka administruar informacionin e dërguar nga nëpunësi Fatbardh Zenelaj, me detyrë “Sekretar i Përgjithshëm”, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, në përmbajtje të së cilave ngrihen pretendime për parregullsi të lejuara në zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procedimit disiplinor të nisur në ngarkim të nëpunësit në fjalë.

Konkretisht, në përmbajtje të informacionit dhe të dokumentacionit të administruar bashkëlidhur tij, nëpunësi parashtron se, gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore në ngarkim të

tij, nga ana e Komisionit të Disiplinës dhe Kryetarit të këtij organi, janë kryer shkeljet e evidentuara si më poshtë:

Së pari, sa i takon përbërjes së organit administrativ i cili ka tagrin për zhvillimin e procedimit disiplinor, Komisioni i Disiplinës, pretendohet se nuk janë respektuar kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të dala për zbatim të tij, e konkretisht, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 01, datë 21.01.2025, të DAP, “Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”. Parregullsitë në këtë rast, konstatojnë në:

- *Caktimin e titullarit të institucionit si Kryetar i Komisionit Disiplinor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit si dhe në shkelje të parimit të paanshmërisë dhe shmangies së konfliktit të interesave, në kuptim të nenit 11 dhe 12, të Kodit të Procedurave Administrative.*
- *Caktimin në cilësinë e përfaqësuesit të burimeve njerëzore, të nëpunësit të emëruar në pozicionin “Përgjegjës, Sektori i Burimeve Njerëzore”, në shkelje të ligjit, pasi në cilësinë e këtij anëtari duhet të jetë “Drejtuesi i njësisë përgjegjëse për burimet njerëzore”, që korrespondon me nëpunësin e emëruar në pozicionin “Drejtor Drejtorie”.*
- *Caktimin e nëpunësit më të vjetër të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore. Në lidhje me këtë aspekt, nëpunësi parashtron se, ky anëtar i Komisionit Disiplinor nuk është i përfaqësuar, pasi, në kushtet kur, ecuria disiplinore ka nisur në ngarkim të Sekretarit të Përgjithshëm, në cilësinë e këtij zyrtari duhet të ishte një nëpunës civil i nivelit të lartë drejtues, me përvojë dhe vjetërsi në këtë pozicion.*
- *Anëtari i Komisionit të Disiplinës, në cilësinë e nëpunësit më të lartë civil në institucion, i cili duhet të jetë edhe Kryetar i organit disiplinor, është i papërfaqësuar në këtë rast.*

Për sa evidentohet në informacionin e ardhur pranë Komisionerit, nga ana e nëpunësit pretendohet se, përbërja e Komisionit Disiplinor nuk është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, si dhe anëtarët e caktuar në përbërje të këtij organi discipline, nuk janë përcaktuar në mbështetje të kritereve të qarta, objektive dhe transparente që parashikon baza ligjore që rregullon këtë institute të ligjit.

Së dyti, sa i përket vendimit të ndërmjetëm nr. 75/1 (nr.369/4 prot.), datë 16.04.2026, të Komisionit Disiplinor, “Për pezullimin nga detyra të nëpunësit civil z. Fatbardh Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit”, nëpunësi parashtron se, ky vendim është marrë në kundërshtim me parimet themelore të procedurës administrative dhe legjisllacionin në fuqi, si dhe në mungesë të një analize të plotë dhe objektive të rrethanave konkrete të çështjes.

Së treti, nëpunësi parashtron se, gjatë periudhës që ka qënë me paaftësi të përkohshme në punë (*raport mjekësor*), punonjës të institucionit kanë vijuar të ushtrojnë presion mbi të duke e kontaktuar me mjete të ndryshme komunikimi, duke krijuar një situatë presioni të pajustificuar dhe të papërshtatshme, e finalizuar me hapjen e zyrës së nëpunësit pa prezencën e tij.

Së katërti, sa i përket urdhrin nr. 85, (nr. 433 prot.), datë 06.05.2026, të Avokatit të Popullit, "*Për zëvendësimin dhe caktimin e ushtrimit të funksioneve të Sekretarit të Përgjithshëm*", me anë të së cilit, është urdhëruar zëvendësimi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe caktimi i znj. Etrita Petriti, me detyrë "*Përgjegjëses e Burimeve Njerëzore*", të ushtrojë detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm, nëpunësi parashtron se, ky akt është nxjerrë në kundërshtim me parimet themelore të organizimit të administratës publike, me frymën dhe qëllimin e legjislativitetit për nëpunësin civil.

Në këto kushte, nëpunësi ka kërkuar ndërhyrjen e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për verifikimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera nga ana e Komisionit Disiplinor dhe organeve të tjera, në lidhje me këtë rast.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave të parashikuara në pikën 1, të nenit 11 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara nga nëpunësi Fatbardh Zenelaj, vlerësoi se ka dyshime të arsyeshme për parregullsi të lejuara gjatë administrimit të shërbimit civil, e në këto rrethana ka filluar procesin e verifikimit të informacionit.

Nëpërmjet shkresës nr. 581/2 prot., datë 11.05.2026, "*Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e informacionit të administruar me shkresat nr.581 prot., datë 06.05.2026, dhe nr. 581/1 prot., datë 11.05.2026, të dërguara nga nëpunësi Fatbardh Zenelaj*", ka vënë në dijeni institucionin për fillimin e verifikimit të ligjshmërisë së kësaj procedure disiplinore, si dhe ka kërkuar dokumentacionin në të cilën është materializuar ajo.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Avokati i Popullit, me shkresën nr. 482/1 prot., datë 15.05.2026, me objekt: "*Kthim përgjigje dhe përcjellje dokumentacioni*", e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 581/3 prot., datë 19.05.2026, ka dërguar dokumentacionin në të cilin materializohet procedura disiplinore e ndjekur në këtë rast.

Nga përmbajtja e dokumentacionit të administruar rezulton se, me urdhrin e brendshëm nr.39, (nr. 39 prot.), datë 28.02.2014, "*Për emërimin në detyrë të Sekretarit të Përgjithshëm Z. Fatbardh Zenelaj*", të Avokatit të Popullit, nëpunësi Fatbardh Zenelaj, është emëruar në pozicionin "*Sekretar i Përgjithshëm*", në institucionin e Avokatit të Popullit, kategoria I-a.

Në vijim të marrëdhënies së punësimit në këtë pozicion pune, rezulton se, Avokati i Popullit, në cilësinë e titullarit të institucionit dhe të eprorit direkt të nëpunësit në fjalë, me

shkresën nr. 369 prot., datë 09.04.2026, “*Relacion mbi konstatimin e shkeljeve disiplinore*”, ka konstatuar shkelje të natyrës administrative dhe procedurale të kryera gjatë periudhës 19.12.2025-03.04.2026, nga nëpunësi Fatbardh Zenelaj, me detyrë “*Sekretar i Përgjithshëm*”, të cilat i ka vlerësuar dhe konstatuar si shkelje shumë të rënda, e për rrjedhojë, i ka kaluar për shqyrtim Komisionit të Disiplinës, duke kërkuar kryerjen e një hetimi administrativ të thelluar.

Më tej, me urdhrin nr.71, (nr.369/1 prot.), datë 10.04.2026, ndryshuar me urdhërin nr.71/1, (nr. 369/2 prot.), datë 14.04.2026, të Avokatit të Popullit, “*Për një ndryshim në urdhrin nr. 71, datë 10.04.2026, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues”*”, është ngritur Komisioni Disiplinor me qëllim shqyrtimin e shkeljeve të pretenduara disiplinore dhe zhvillimin e procedurës përkatëse administrative.

Komisioni i Disiplinës, pasi ka marrë në shqyrtim kërkesën e eprorit direkt të nëpunësit në fjalë, me vendimin nr. 75, (nr.369/3 prot.), datë 16.04.2026, “*Për fillimin e ecurisë disiplinore*”, ka vendosur, fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të nëpunësit Fatbardh Zenelaj, i emëruar në pozicionin “*Sekretar i Përgjithshëm*”, për shkeljet e pretenduara të parashikuara në nenit 57, pika 1, germa a), të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Më tej, Komisioni i Disiplinës me vendimin nr. 75/1, (nr. 369/4 prot.), datë 16.04.2026, “*Për pezullimin nga detyra të nëpunësit civil, z. Fatbardh Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit*”, ka vendosur pezullimin e nëpunësit civil deri në marrjen e vendimit përfundimtar.

Titullari i institucionit, duke vepruar si Kryetar i Komisionit Disiplinor, me shkresën nr.369/5 prot., datë 16.04.2026, “*Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore*”, ka njoftuar nëpunësin për nisjen e ecurisë disiplinore dhe për vendimin e pezullimit të tij, duke i parashtruar shkeljet disiplinore të pretenduara në ngarkim të tij, duke e njohur edhe me të drejtën për të paraqitur me shkrim pretendimet dhe provat, thirrjes së dëshmitarëve, mbrojtjes personalisht ose me përfaqësues ligjor; si dhe me kohën e shqyrtimit të shkeljes së pretenduar, e cila është vendosur në datën 24.04.2026, ora 14:00.

Sa i takon ligjshmërisë së procedurës disiplinore të ndjekur në këtë rast, vlerësojmë se fillimisht duhet të analizohet baza ligjore që e rregullon këtë institut të ligjit.

Konkretisht, në nenin 57, “*Përgjegjësia për masat disiplinore*”, përcaktohet përgjegjësia e nëpunësit civil për shkeljen me faj të detyrimeve sipas ligjit, si edhe kategorizimi i shkeljeve në:

- a) shkelje shumë të rënda; b) shkelje të rënda; c) shkelje të lehta.

Më tej, në pikën 2, të këtij neni, parashikohet kategorizimi i shkeljeve shumë të rënda; në pikën 3, i shkeljeve të rënda dhe në pikën 4, i shkeljeve të lehta.

Ndërsa, në nenin 58, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, parashikohen “Llojet e masave disiplinore” të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, në një rast kur evidentohen shkelje disiplinore:

“Masat disiplinore që mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil janë:

- a) vërejtje;*
- b) mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj;*
- c) pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet.*
- ç) largim nga shërbimi civil”,*

dhe në nenin 59, të këtij ligji, përcaktohet kompetenca dhe procedura për dhënien e tyre. Sipas pikës 2, të kësaj dispozite, masa e parashikuar në germën a) të nenit 58, jepet nga eprori direkt i nëpunësit, ndërsa masat e parashikuara në gërmat b), c) dhe ç) jepen nga Komisioni Disiplinor, për çdo nëpunës civil në institucion.

Në referim të pikës 10, të nenit 59, të ligjit në fjalë, është parashikuar se, Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregullat e hollësishme të procedurës disiplinore, si dhe rregullat për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor. Ky detyrim ka gjetur zbatim me miratimin e Vendimit nr. 115, datë 5.3.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar.

Konkretisht, në aktin nënligjor që rregullon disiplinën në shërbimin civil, (VKM nr.115/2014), në kreun I “Organet Disiplinore”, pika 1, përcaktohet se:

*“Organet disiplinore, sipas ligjit, janë: Komiteti Kombëtar i Përzgjedhjes, për anëtarët e TND-së (KKP); **komisioni disiplinor (KD)**, për nëpunësit e tjerë dhe eprori direkt”.*

Ndërsa në pikën 3, të këtij kreu, sanksionohet se:

“Për institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet, komisioni disiplinor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë dhe ka përbërjen e mëposhtme:

- a) nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;*
- b) eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
- c) drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;*
- ç) nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;*
- d) nëpunësin më të vjetër civil të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.”*

Më tej, me qëllim zbatimin e unifikuar të rregullave dhe procedurës administrative disiplinore, nga ana e institucioneve të administratës shtetërore, Departamenti i Administratës Publike ka nxjerrë Udhëzimin nr. 01, datë 21.01.2025, “Për organet disiplinore dhe procedurën e shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

Në rastin konkret, pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar dhe bazës ligjore të cituar më lart, sa i takon pretendimeve të ngritura nga nëpunësi Fatbardh Zenelaj, rezulton se:

Së pari, sa i përket **organit administrativ i cili ka tagrin për nisjen e ecurisë disiplinore**, ky është një aspekt që rregullohet në Krun II, pika 7, të VKM nr.115/2014 të si dhe në Krun II, pika 7, të Udhëzimit nr. 1, datë 21.01.2025, “Për organet disiplinore dhe Procedurën e Shqyrtimit të Shkeljeve Disiplinore”, të DAP, ku parashikohet se, **eprori i drejtpërdrejtë**, në rastet kur vihet në dijeni të një pretendimi për shkelje disiplinore, e vlerëson paraprakisht atë, bën vlerësimin e shkeljeve disiplinore me faj, të pretenduara përkundrejt nëpunësit civil dhe i klasifikon ato.

Gjithashtu, në këtë akt nënligjor, në pikën 3/2/a, parashikohet se: eprori i drejtpërdrejtë për nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese, është Titullari i institucionit, që në rastin konkret përkon me Avokatin e Popullit. Në këto kushte, ky zyrtar **është i legjitimuar** për vlerësimin dhe klasifikimin e pretendimeve të shkeljeve disiplinore të kryera nga Sekretari i Përgjithshëm.

Sa i takon **respektimit të ligjshmërisë në momentin e krijimit të Komisionit Disiplinor**, sipas urdhrin nr. 71, (nr.369/1 prot.), datë 10.04.2026, të titullarit, “Për ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues”, i ndryshuar me urdhrin nr.71/1, (nr. 369/2 prot.), datë 14.04.2026, të titullarit, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 71, datë 10.04.2026, “Për ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues””, duhet të vlerësojmë paraprakisht përbërjen e tij, e cila paraqitet e tillë:

1. Z. Endrit Shabani – Epror Direkt - Kryetar;
2. Znj. Etrita Petriti – Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore - Anëtare;
3. Znj. Anila Neprevishta – Nëpunësi më i vjetër civil në institucion - Anëtare;
4. Z. Enio Haxhimihali – Për nëpunësin më të lartë në institucion- Anëtar;
5. Znj. Kejsi Rizo – Për nëpunësin më të vjetër në njësi - Anëtare, zëvendësuar me anëtares znj. Fjona Zaçaj, me urdhrin nr. 71/1, (nr. 369/2 prot.), datë 14.04.2026, të titullarit.

Duke analizuar rolin e secilit prej anëtarëve të Komisionit të Disiplinës, në raport me zbatimin e kërkesave të ligjit, konstatohet se:

- a. Kryetar i Komisionit Disiplinor **është caktuar titullari i institucionit**, i cili është njëkohësisht edhe eprori i drejtpërdrejtë i nëpunësit në procedim.

Referuar përkufizimeve të nenit 4, pika 1 germa e) të ligjit nr. 152/2013” Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit nr. 01, datë 21.01.2025, të DAP, pika 3.2, germa a), rezulton se, titullari i institucionit, është eprori i drejtpërdrejtë, në rastin e Sekretarit të Përgjithshëm. Për këtë arsye, ky zyrtar duhet të vendoset në rolin e anëtarit të Komisionit Disiplinor (KD), në cilësinë e eprorit direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore. Ky përcaktim gjën mbështetje edhe në germën b), pika 3, e VKM-së nr. 115, datë 05.03.2014, e ndryshuar, të cituar më sipër në këtë vendim.

Më tej, në pikën 18.2, kreu III, i Udhëzimit të DAP-it, parashikohet se anëtarët e përhershëm të Komisionit Disiplinor janë:

“a) Nëpunësi më i lartë civil i institucionit ku ushtron detyrën nëpunësi në procedim disiplinor. Nëpunësi më i lartë civil është Kryetar i Komisionit Disiplinor,....”

Në vijim, në pikën 22, kreu III, të këtij akti, parashikohet mënyra e zëvendësimit të Kryetarit të Komisionit Disiplinor, duke cituar se:

Pika 22.2 “Zëvendësimi i Kryetarit të KD-së bëhet nga titullari i institucionit.”

Referuar dispozitave të cituara sa më lart, në rastin në fjalë, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Disiplinës, duhet të jetë një nëpunës civil i të njëjtës kategori të nëpunësisë civile, i caktuar nga titullari i institucionit.

- b. Anëtari i Komisionit Disiplinor, **përfaqësues i njësisë së burimeve njerëzore**, konstatohet se, është caktuar znj. Etrita Petriti, e cila ushtron detyrën e “Përgjegjëses së Burimeve Njerëzore”, në institucionin e Avokatit të Popullit. Ky veprim vjen në kundërshtim me kërkesat e ligjit, pasi në cilësinë e këtij anëtari duhet të jetë drejtuesi i njësisë përgjegjëse, që në këtë rast, përkon me drejtorin e drejtorisë që mbulon administrimin e burimeve njerëzore të institucionit. Në këtë përfundim arrihet duke u bazuar në Kreun I, pika 3, germa c), të VKM- së nr. 115, datë 05.03.2014, e ndryshuar, ku parashikohet: “...drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion...”.

Referuar strukturës organizative të institucionit të Avokatit të Popullit, e miratuar me urdhrin nr.09, datë 13.01.2025, “Për një ndryshim në urdhërin nr 02, datë 03.01.2024, ”Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit, i ndryshuar”, të Avokatit të Popullit, konstatohet se, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në institucion është e organizuar në njësi organizative Drejtori, e në këto rrethana, drejtues i njësisë përgjegjëse për institucionin është nëpunësi i

emëruar Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve, i cili për shkak të pozicionit të punës që mban, duhet të jetë edhe anëtar i Komisionit Disiplinor.

- c. Anëtarët e Komisionit Disiplinor, në cilësinë e **nëpunësit më të vjetër civil në institucion** dhe **nëpunësit më të vjetër në njësinë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore**, rezulton se, nuk janë caktuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit.

Referuar përbërjes së organit disiplinor, në **cilësinë e nëpunësit më të vjetër** është caktuar znj. Anila Nepravishta, e cila, sipas dokumentacionit të dërguar nga institucioni, është emëruar me urdhrin nr. 05/2 prot., datë 06.01.2017, *“Për transferimin e përhershëm në kuadër të rriturimit, brenda institucionit të Avokatit të Popullit, të Ndhmës Komisioneres znj. Anila Nepravishta”*, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin *“Ndhmës Komisioner”*, në Seksionin e Përgjithshëm, në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Ndërsa, në cilësinë e anëtarit **nëpunës më i vjetër i njësisë** është caktuar znj. Fjona Zaçaj, që sipas dokumentacionit të dërguar nga institucioni, është emëruar me urdhrin nr. 106, datë 10.04.2019, *“Për transferimin e përhershëm të znj. Fiona Zaçaj në pozicionin Ndhmës Komisioner në Seksionin e Veçantë, në përfundim të periudhës së pezullimit”*, të Sekretarit të Përgjithshëm, në pozicionin *“Ndhmës Komisioner”*, në Seksionin për Policinë, Shërbimin Sekret, Burgjet, Forcat e Armatosura dhe Pushtetin Gjyqësor (*Seksioni i veçantë*), kategoria II-b.

Me qëllim që të arrijmë në një konkluzion të saktë për këtë aspekt, Komisioneri i është referuar të dhënave të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, të ushtruar pranë institucionit të Avokatit të Popullit, i cili është përmbyllur me vendimin nr. 60, datë 04.07.2023, të Komisionerit. Duke analizuar aktet e emërimit të nëpunësve civilë të institucionit, përkatësisht në pozicionet: *“Ndhmës Komisioner”*, me klasë page I-4, konstatohet se, ka punonjës më të vjetër të kësaj kategorie, krahasuar me vjetësinë e nëpunësve A. Nepravishta dhe F. Zaçaj, të caktuara në përbërje të Komisionit Disiplinor.

Konkretisht, sipas të dhënave rezulton se, nëpunësit L. Xhillari, (*akti i emërimit nr. 72, datë 15.05.2008*) dhe A. Gjoleka, (*akti i emërimit nr. 86, datë 13.07.2009*) aktualisht janë punonjës më të vjetër në pozicionin e punës: *“Ndhmës Komisioner”*.

Por, nëse do të referohemi akteve të emërimit sipas vjetërsisë në punë, krahasuar me anëtarët e KD-së të cilët po analizojmë, rezultojnë edhe nëpunës të tjerë më të vjetër në kategoritë përkatëse që kërkon akti nënligjor në fjalë.

Në këto kushte, akti administrativ nr. 71, (nr.369/1 prot.), datë 10.04.2026, të Avokatit të Popullit, *“Për ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues”*, i ndryshuar me urdhrin nr.71/1, (nr. 369/2 prot.), datë 14.04.2026, të Avokatit të Popullit, *“Për një ndryshim në urdhrin nr. 71, datë*

10.04.2026, “Për ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues”, që ka dalë për krijimin e organit disiplinor, që në këtë rast është Komisioni i Disiplinës, vjen në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil. Në këto rrethana, bazuar në nenet 109 dhe 113 të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, akti objekt shqyrtimi duhet të anulohet nga ana e organit që e ka nxjerrë këtë akt dhe të rregullohen pasojat.

Së dyti, sa i përket ligjshmërisë së veprimeve administrative që janë kryer në vijim të procedurës disiplinore të ndjekur në këtë rast, ku përfshihet edhe vendimi i ndërmjetëm nr. 75/1, (nr.369/4 prot.), datë 16.04.2026, i Komisionit Disiplinor, “Për pezullimin nga detyra të nëpunësit civil z. Fatbardh Zenelaj, Sekretar i Përgjithshëm i institucionit të Avokatit të Popullit”, nëpërmjet të cilit është vendosur pezullimi nga shërbimi civil i nëpunësit F. Zenelaj, Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur, procesi është zhvilluar nga një organ disiplinor i ngritur në kundërshtim me kërkesat e ligjit, sikurse u arsyetua më lart, rrjedhimisht, edhe të gjitha aktet e tjera administrative të nxjerra prej tij, janë të kundraligjshme dhe duhen anuluar.

Sa i përket urdhrin nr. 85, (nr. 433 prot.), datë 06.05.2026, të Avokatit të Popullit, “Për zëvendësimin dhe caktimin e ushtrimit të funksioneve të Sekretarit të Përgjithshëm”, me anë të së cilit, është urdhëruar zëvendësimi i Sekretarit të Përgjithshëm dhe caktimi i znj. Etrita Petruti, me detyrë “Përgjegjëses e Burimeve Njerëzore”, të ushtrojë detyrat e Sekretarit të Përgjithshëm, Komisioneri vlerëson se ky akt është nxjerrë në kundërshtim me kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, pasi së pari nuk është rezultat i aplikimit të ndonjë instituti konkret të ligjit të shërbimit civil dhe së dyti, nuk përfaqëson hierarkinë administrative që duhet të ndiqet gjatë vakancës së krijuar për një pozicion pune në shërbimin civil, e cila gjithmonë plotësohet nga një nivel më i lartë në strukturën organizative të institucionit.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të neneve 109 dhe 113, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe në neneve 16, pika 8 dhe 35, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, e ndryshuar,

VENDOSA:

Të paralajmëroj institucionin e Avokatit të Popullit, për rregullimin e situatës së ligjshmërisë, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke vepruar në këtë mënyrë:

1. Avokati i Popullit në zbatim të nenit 109 dhe 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, nëpërmjet një akti të ri me shkrim të anulohë urdhrin nr. 71, (nr.369/1 prot.), datë 10.04.2026, “Për ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues”, i ndryshuar me urdhrin nr.71/1, (nr. 369/2 prot.), datë 14.04.2026, “Për një ndryshim në urdhrin nr. 71, datë 10.04.2026, “Për ngritjen e komisionit disiplinor për shqyrtimin e procedimit disiplinor ndaj një nëpunësi civil të nivelit të lartë drejtues””, si dhe të rregullojë pasojat, duke anuluar të gjitha aktet e tjera që kanë dalë në përfundim të veprimeve juridike të kryera në lidhje me ecurinë disiplinore të ndjekur në ngarkim të nëpunësit Fatbardh Zenelaj.
2. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit të Avokatit të Popullit, duhet të ndjekë ecurinë e procesit administrativ, për realizimin e veprimeve të mësipërme.
3. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **10** ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, institucioni të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
5. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe nëpunësi Fatbardh Zenelaj.
6. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Lefterije Lleshi (Luzi)